



REPUBLIKA E SHQIPËRIË  
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË



Nr 876/6 Prot

Tiranë, më 21.10.2021

Nr 876 Dosje

URDHËR

(PËR VENIEN E SEKUESTROS KONSERVATIVE)

Drejtuar : Qendra Kombëtare e Biznesit Tiranë,

Unë, Haxhi Ismaili, me detyrën e Përmbaruesit Gjyqësor, pranë Zyrës së Përmbarimit Privat "3H" SHPK, në referim të *Urdherit të Ekzekutimit Nr.1375 prot date 17.06.2021* i Gjykates Administrative të Shkalles se Pare Tirane, kam vënë në ekzekutim këtë *urdhër*, duke regjistruar në dosjen përmbarimore Nr.876 kërkesën e *Kreditorit*- Dega e Doganes Tirane për vënie në ekzekutim të *titullit ekzekutiv*, Vendimi për rikuperim me force të borxhit doganor me Nr.64 prot date 15.08.2016 i Deges Doganore Tirane, për *Debitorin* – Shoqeria "Skenderi G" SHPK me NIPT K04004205V me administrator Z.Frident Kuqi.

Pasi fillova procesin e ekzekutimit të detyrueshëm, duke i dërguar debitorit Lajmërimin për të ekzekutuar vullnetarisht detyrimin që përmban Urdheri i Ekzekutimit në referim të neneve 517 dhe 518 të K.Pr.Civile,

KONSTATOVA Se :

Debitori: **Shoqeria "Skenderi G" SHPK me NIPT K04004205V me administrator Z.Frident Kuqi**, ka marrë njoftimin e Lajmërimit për Ekzekutimin Vullnetar të Detyrimit dhe nuk i është përgjigjur respektimit të afatit dhe kërkesave të këtij lajmërimi.

Në këto kushte në referim të nenit 527 të K.Pr.Civile duhet të filloj ekzekutimin e detyrueshëm, duke vënë sekuestër mbi kreditë e debitorit **Shoqeria "Skenderi G" SHPK me NIPT K04004205V me administrator Z.Frident Kuqi**, në masën që do të jetë e nevojshme për plotësimin e detyrimit.

Përsa më sipër, në referim të neneve 36 pika (e), 37 pikat (b) dhe 53 (paragrafi i 1-rë) të Ligjit Nr. 26/2019 "Per Sherbimin Permbarimor Gjyqesor Privat",

Adresa :Bulevardi Zogu I, Sheshi Franc Nopça, Ndertesa 6, Hyrja 10, Apartamenti 23, Tirane

Website: www.3-h.al

Cel. 0692099711

Email: shpgj\_3h@yahoo.com

## URDHËROJ

1. Qendra Kombëtare e Biznesit Tiranë, të bëjë bllokimin e kuotave dhe të drejtat që rrjedhin nga zotërimi i aksioneve nga:
  - **Subjekti: “Skenderi G” SHPK me NIPT K04004205V me administrator Z.Frident Kuqi.**
2. Për informimin, bllokimin e shitjes së aksioneve dhe tjetërsimit të aktivitetit dhe veprimet që duhet të kryeni pas marrjes së njoftimit të këtij urdhri në lidhje me debitorin e sipërpërmendur të njoftohem në rrugë zyrtare brenda afatit administrativ nga ana Juaj.
3. Personat që bëhen pengesë, brenda afatit të përgjigjes zyrtare, që nga dita e njoftimit të këtij urdhri, do të përgjigjen sipas dispozitave sanksionuese që parashikon Kodi i Procedurës Civile dhe Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, në lidhje me pengimin e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore apo të titujve ekzekutive, ku aplikohet sanksioni i gjobes në shumën 50.000 lekë në zbatim të nenit 606 të K.Pr.Civile si dhe kallëzim për pengim ekzekutimi në zbatim të nenit 320 të K.Penal.
4. Ky urdhër është i vlefshëm deri në një urdhër të dytë.
5. Ky urdhër mbahet në 4 (katër) kopje, dhe u njoftohet palëve të cilat kanë të drejtën e ankimit në gjykatë brenda 5 ditëve, nga dita e marrjes dijani.

---

### ZYRA E PËRMBARIMIT PRIVAT “3 H” SHPK PERMBARUES GJYQESOR

Haxhi ISMAILI



Adresa: Bulevardi Zogu I, Sheshi Franc Nopça, Ndertesë 6, Hyrja 10, Apartamenti 23, Tirane

Website: [www.3-h.al](http://www.3-h.al)

Cel. 0692099711

Email: [shpgj\\_3h@yahoo.com](mailto:shpgj_3h@yahoo.com)